



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .03.2023

MBLEDHJA Nr. 10,
Datë 03.03.2023, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 03.03.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 10 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s datë 24.02.2023
2. Mbi licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike” dhe mbi një ndryshim vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”
5. Informacion mbi monitorimin e shoqërisë OST sh.a. lidhur me realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën Janar - Gusht 2022
6. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI